



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 09

Prishtinë, më 09.06.2021, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Enis Kervan, Fitim Uka, Albena Reshitaj, Arijeta Rexhepi, Adriana Matoshi, Jahja Kokaj, Memli Krasniqi, Eliza Hoxha, Vlora Dumoshi dhe Jasmina Dediq, anëtarë.

Përfaqësues të tjerë: Adea Kondirolli – ORCA, si dhe Mediat e Kuvendit.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli, Donjeta Jashari dhe Diellza Halimi.

Mbledhjen e kryesoi Ardian Gola, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.06.2021;**
- 3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.12/12 të dt. 21.5.2021 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës miratohet nga anëtarët e Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 01.06.2021

Procesverbali i mbledhjes së datës 01.06.2021, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.12/12 të dt. 21.5.2021 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Ardian Gola tha se Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2021, ka shqyrtuar Vendimit të Qeverisë nr.12/12 të dt. 21.5.2021 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Anëtarët e Komisionit kanë konstatuar se CV-ja e kandidatit Seb Bytyçi përmban gabime drejtshkrimore dhe sintaksore dhe si e tillë të mos procedohet në Kuvend pa u bërë përmirësimet e gabimeve nga ana e kandidatit. E vlerëson si vendim të drejtë të Komisionit që një dokument me gabime të tilla për një pozitë shumë me rëndësi të mos iu shpërndahet deputetëve të Kuvendit. Kandidati i lartcekur ka përmirësuar gabimet në CV sipas kërkesës së Komisionit, funksionalizimi i KSHC-së është çështje urgjente kur kemi parasysh se testi i maturës mbahet me 26 qershor dhe të gjitha programet studimore të institucioneve të arsimit të lartë duhet të jenë të akredituara deri më atë datë, e nëse nuk akreditohen tha se sfidat janë edhe me të mëdha, prandaj propozoi që të miratohet vendimi i Qeverisë dhe t'i rekomandohet Kuvendit të bëjë ratifikimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC-së). Po ashtu tha Komisioni në kuadër të kompetencave të veta do t'u kërkojmë përgjegjësi për secilin veprim dhe hap që ndërmarrin në funksion të përmbushjes së mandatit të tyre në Këshill.

Memli Krasniqi tha se e kupton presionin e Qeverisë, por arsyetimi se duhet trajtuar me urgjencë nuk qëndron, vlerëson se është një proces i manipuluar dhe jo i duhur në kuptimin e asaj se për çfarë institucioni po flasim. Tha se asnjë prej anëtarëve të KSHC-së as tash as në të kaluarën nuk lexojnë dokumentacionin për akreditim, sepse ekziston një proces për të cilin duhen rekrutuar ekspertë, të cilët vendosin se a duhet të akreditohet një institucion apo programe të caktuara studimore, ky proces ka vazhduar përkundër mungesës së anëtarëve ose ndërrimit të anëtarëve të KSHC-së dhe në momentin kur në një proces të rregullt do të zgjidheshin njerëz reprezentativë dhe meritore, dhe jo siç ka ndodhur në këtë proces, atëherë ata do të mund thjesht të miratonin rekomandimet që vijnë prej atyre që janë të thirrur për me marrë vendime profesionale për akreditim. Tha se ngutia për të kaluar symbyllur një vendim të kësaj natyre dhe rëndësie është e papranueshme dhe se nuk përkrah miratimin e vendimit.

Vlora Dumoshi tha se është shqetësuese që ky proces në mënyrën se si po përpiqet të përmbyllet. Tha se i ka analizuar CV-të e kandidatëve dhe lënë shumë për të dëshiruar. Tha se është i njohur

fakti që pjesa e arsimit lëngon shumë në Kosovë dhe pasi ky është organi më i lartë për cilësi, nuk pajtohet që ky proces të vazhdojë në këtë formë. Tha se e dimë përbërjen e Komisionit që kanë përzgjedhur këta kandidatë dhe pasojat e çdo procesi të ngutshëm nuk janë të mira.

Arijeta Rexhepi tha se shqyrtimin e vendimit të Qeverisë për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar dhe se asgjë nuk është e ngutshme, por një proces sipas procedurave të rregullta, përzgjedhja e kandidatëve është bërë nga një komision kredibil, ku ka qenë prezent edhe shoqëria civile edhe ka ecur në faza ashtu siç e parashih ligji dhe ka ardhur në Komision, prandaj duhet të procedojmë tutje.

Eliza Hoxha tha se sa i përket shqyrtimit të vendimit të Qeverisë, personalisht por edhe si subjekt politik kanë pasur vërejtjet e tyre për disa nga anëtarët që janë pjesë e kësaj liste, në veçanti njërit të zgjedhur nga ministrja prej listës së gjerë, i cili ka konflikt interesi në proceset e mëhershme të akreditimit dhe ka dy vende pune aktualisht. Tha se ai nuk e ka dëshmuar të kundërtën, pavarësisht fjalëve dhe e-mail që dërgon dhe tha se vazhdon të mendoj se nëse jemi përjashtuar përnjëmend nga ENQA dhe EQAR për shkak të problematikave të ngjashme dhe të llojeve të tjera që kanë qenë interferenca politike të llojeve të ndryshme, atëherë ky proces ishte dashur të ishte i pastër si loti dhe të shfaqte një faqe të re pa dallime politike për të gjithë ne që kemi dëshirë e interes për ta çuar arsimin në një tjetër nivel të zhvillimit, në politikë bërje dhe vendimet që merren për të. Tha se pavarësisht urgjencës, rrethanave të pandemisë dhe Këshillit që ka qenë jofunksional edhe në mandatin e kaluar, ndoshta është mirë të shohim se çfarë mund të bëjmë, sepse nuk është modeli më i mirë për juve si Qeveri, për neve si deputetë dhe si pjesëtarë të institucioneve të arsimit të lartë të bëjmë një hap të tillë.

Fitim Uka tha se ky proces nuk është që ka qenë jo transparent ashtu siç po etiketohet. Tha se në një komision që ka pasur edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave, ku kanë marrë një vendim dhe ia ka dërguar ministres për t'i përzgjedhur disa kandidatë, të cilët asnjë nuk i ka zgjedhur në baza partiake. Tha se nëse ka qenë dikush që ka dhënë vërejtje për procesin, ata kanë qenë deputetët e LVV-së në mbledhjen e javës së kaluar në lidhje me një kandidat. Tha se nëse keni vërejtje për kredencialet akademike, titujt akademikë, plagjiaturën në ndonjë prej publikimeve të kandidatëve, atëherë do t'iu bashkëngjitesha, por tha se nuk është korrekte dhe është politike etiketimi i tërë procesit.

Eliza Hoxha tha se po ndalet të rasti i CV-së së z. Seb Bytyçi që i është kërkuar përmirësim, i njëjti sipas dëshmive figuron që punon në dy vende të punës dhe është problem, sepse ky është një nga kriteret se kush nuk mund të emërohet sipas Udhëzimit Administrativ, sepse është konflikt interesi. Po ashtu, i njëjti person nuk figuron në listën e ngushtë prej nëntë anëtarëve dhe se kjo është për t'u brengosur, sepse janë dashur të përzgjidhen katër anëtarë shqiptarë të kësaj liste, tre janë zgjedhur nga kjo listë, por i katërti jo. Po ashtu, personi i njëjtë ka qenë bartës i programit kur është akredituar Riinvest dhe ka figuruar si i rregullt në këtë institucion, nëse përnjëmend figuron se ky

person ka punuar edhe më herët në këtë institucion, kjo i bie që ai ka qenë njëri nga mashtuesit e këtij procesi dhe se është e pa tolerueshme që i njëjti që ka bërë gjëra të tilla, që ka jetuar në Angli dhe është deklaruar si i rregullt në Riinvest dhe që është akredituar ky institucion me emrin e tij si bartës i programit, dhe sot të jetë në KSHC për të verifikuar akreditimin e institucioneve dhe programeve, tha se është problematike edhe pse ai mund të jetë person me kredibilitet, por ne po flasim për konflikte interesi.

Ardian Gola tha se nëse qëndrojnë pretendimet e parafolësit, bënë zotim publik se nëse ky kandidat ka deklaruar rrejtshëm punët e tij, pas ratifikimit do të thërrasim në një mbledhje komisioni urgjentisht ministren dhe do ta shkarkojmë pikërisht mbi këtë bazë. Tha se ideja është që mos ta vonojmë procesin dhe të krijojmë një kuorum dhe të funksionalizojmë Këshillin, anëtarët e të cilit do t'i kemi nën llupë dhe do t'i shkarkojmë në rast të deklarimeve të rrejtshme dhe nëse nuk punohet. Tha se sipas drejtorit të Agjencisë së Akreditimit, z. Naim Gashi, nëse ngec mbrapa ky proces i ratifikimit, kollapson sistemi i arsimit të lartë.

Memli Krasniqi tha se ne jemi persona politikë dhe është mirë të kursejmë ngacmimet politike, sepse nuk kemi nevojë të ngacmohemi në Komision. Tha se e vlerëson zotimin e z. Gola, sepse jeni profesorë shumica këtu, dhe nuk besoj se do të ishit të kënaqur për dhënien e besimit një komisioni jo kredibil. Tha se është normale nëse Qeveria kërkon nga ju që të shtyhet procesi përpara, sepse kështu funksionon. Po ashtu, tha se sistemi arsimor është gjysmë i kollapsuar dhe se Këshilli është fajtori kryesor për këtë dhe se shumë njerëz që kanë qenë pjesë e atij Këshilli ndër vite kanë qenë punëtorë të grupeve të caktuar dhe jo në shërbim të arsimit dhe se rreziku është që sot prapë po bëjmë të njëjtën gjë. Tha se nuk ka dyshime në pjesën akademike të z. Seb Bytyçi, por e vërteta është se në listë nuk ka qenë, përndryshe më mirë është të jetë ky sesa nipi i z. Besnik Bislimit, pa i hyrë në hak as jetës së tij akademike, por gabimi është që nuk e kanë futur emrin e tij në listën ku kishte dashur me qenë dhe tash kanë katapultuar jo përmes procedurave ligjore. Po ashtu, tha se Gëzim Tosuni nuk ka faj që ka dajë zv.kryeministrin, por fakti që e ka dajë nuk është dashur që të jetë në këtë Këshill dhe është dashur të vazhdojë si dekan që ka qenë në universitete publik. Prandaj, tha se këtu shija është e keqe. Tha se nuk e kemi kundërshtimin në aspektin personal as politik, por në kuptimin parimor. Tha se ka shumë rezerva për atë që ka ndodhur deri sot në KSHC dhe me procesin e akreditimit në veçanti dhe favorizimin për sektorin privat dhe tha se jam për krijimin e një komisioni hetimor dhe nxjerrjen e përgjegjësve para drejtësisë.

Eliza Hoxha tha se ideja e të qenurit në këto procese një pjesëtar i shoqërisë civile është fantastike, por në fakt në tërë procesin që ka kaluar përfaqësuesi i shoqërisë civile, në këtë rast z. Rron Gjinoçci, del të jetë konflikti kryesor i interesit, sepse organizata e tij është me mision kryesor në rritjen e cilësisë së arsimit, sidomos në atë universitar dhe është në mbikëqyrje të proceseve akademike. Tha se nëse kishe ndodhur ky rast me këtë kandidat në rrethana të tjera politike, z.Gjinoçci do të protestonte për të shkarkuar dikë, por nuk reagon sepse ka qenë pjesë e një emërimi politik.

Fitim Uka tha se ka kriteret për të qenë anëtar i KSHC-së dhe secili prej tyre i plotëson kriteret. Po ashtu, tha se nuk mund të di pse dikush nuk ka reaguar, por jam për përfshirje të shoqërisë civile, andaj kanë ardhur disa emra për t'i votuar dhe jam për ta bërë këtë, sepse mendoj se nuk ka më të mirë sesa ata emra.

Ardian Gola tha se bazuar në udhëzimin administrativ, komisioni vlerësues ka bërë listën e ngushtë e cila duhet të jetë minimumi më shumë se dyfishi i anëtarëve të nominuar, që do të thotë se ministrja nuk është që ka bërë shkelje, por përkundrazi ka marrë prej atij grupi që është pjesë e minimumit. Në këtë pikë, ai citoi Neni 6, paragrafi 3, që thotë se komisioni përgatit listën e ngushtë të kandidatëve, e cila duhet të jetë së paku sa dyfishi i anëtarëve që zgjidhen duke respektuar kushtet dhe përbërjen gjinore dhe i rekomandon ministrit, pra nuk janë të rekomanduar ata të nënvizuar, por komplet lista e cila në fund të vendimit thotë qartazi se të gjithë këta i plotësojnë kushtet. Në përputhje me këtë paragraf, tha se ministrja ka vepruar në pajtim me normën juridike, edhe pse për shije të keqe mund të diskutojmë, por kjo jo domosdoshmërisht e komprometon procesin, sepse mund të jetë një coincidence.

Eliza Hoxha tha se dyfishi është i nënvizuar – bold – dhe nuk i ka mjaftuar, por ka marrë nga fundi i listës.

Ardian Gola tha se është minimumi i dyfishit, do të thotë mund të jetë më shumë dhe është në diskrecion politik të ministres. Po ashtu, tha se Gëzim Tosuni është i rekomanduar direkt nga komisioni dhe fatmirësisht kështu nga komisioni kemi edhe njerëz që njohim personalisht që janë akoma më të mirë se Gëzim Tosuni.

Albena Reshitaj tha se disa nga anëtarët e Komisionit janë pjesë e Universitetit të Prishtinës dhe njohin problematikat e arsimit në vendin tonë. Tha se nuk ka qenë serioze dhe më ka shqetësuar fakti i kësaj procedure, mungesa e CV-ve me kohë, pastaj problemet me CV-në e kandidatit pa hyrë në substancë, sepse nëse më ishte kërkuar t'i vlerësojë si komision këta kandidatë brenda Ministrisë së Arsimit, do të kisha dhënë tjetër mendim dhe qasje, por tha si deputet na duhet qasje tjetër. Po ashtu, tha se ngutia që është duke ndodhur në këtë proces nuk është mirë, sepse po flasim për një Këshill shumë të rëndësishëm nëse duam të bëjmë reforma të thella në sistemin arsimor në Kosovë. Tha se nuk do të paragjykojë kandidatët dhe kontributin që do të duhej ta japin në të ardhmen, por beson se do të jenë parimorë, apolitikë në vendimet që do të marrin, sepse do të shikojmë me llupë çdo punë të tyre, sidomos ne që jemi pjesë e arsimit në Kosovë. Tha se nuk mund të paragjykojë edhe që do të punojnë keq, por tha se duhet të na kuptoni se është shumë e rëndësishme të bëhet një reformë në arsimin dhe që normalisht që e shikojmë çdo kandidat dhe proces me seriozitet. Tha se ka marrë me vonesë CV-të e kandidatëve dhe nuk ka arritur t'i analizoj në detaje dhe mbi bazën e saj propozoj që votimi të bëhet në mbledhjen e radhës.

Jahja Kokaj tha se përkrah vendimin e qeverisë dhe kandidatët që janë propozuar për KSHC, sa i përket procedura administrative tha se nuk ka njohuri dhe beson që kjo procedurë është bërë konform dispozitave ligjore. Tha se njerëzit e këtij Këshilli i shoh njerëz të cilët kanë kaluar zenitin e potencialeve të tyre shkencore dhe akademike dhe tërë akumulimi i tyre shumëvjeçar do të reflektohet në universitet, por një gjë të tillë tha se nuk e shoh se këta e kanë kaluar këtë zenit. Tha se i ka parë anëtarët paraprakë të Këshillit, por edhe kandidatët e rinj që janë propozuar, te këta të fundit sheh disa të rinj si shkencëtarë fillestarë në shkallën që i pari është më i dobëti, e i fundit më i miri. Tha që i sheh të rinj me potencialë që do të arrijnë, por tash do ta ngriti dorën për të votuar për të katërtit, për arsye se në këtë moment nuk kemi më kredibil, por tha që e rezervoj të drejtën që sa herë shoh që janë gabim të ngriti zërin dhe të rrëzohen.

Ardian Gola tha se nuk ka nguti dhe nuk kemi dashur të dërgojmë në seancë plenare para deputetëve të dërgojmë CV që nuk përmbushin kriterin minimal të shkruarit në gjuhën shqipe, t'i ofendojmë deputetët në atë mënyrë. Tha ta kemi të qartë se këtu nuk po bëhet fjalë për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, aq sa për funksionalizimin e Këshillit, sepse na duhet funksionalizimi për shkak të sfidave jashtëzakonisht të mëdha që ka, pastaj tha se do të shikojmë për çdo parregullsi nëse ka dhe do të nisen procedura të shkarkimit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit, me 6 (gjashtë) vota PËR, 3 (tre) vota KUNDËR dhe 1 (një) votë ABSTENIM, miratuan Vendimin e Qeverisë nr.12/12 të dt. 21.5.2021 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

I Rekomandohet Kuvendit të bëjë ratifikimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC-së) të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA-së), me këtë përbërje: Hasnije Iliazi, Gezim Tosuni, Krenare Pireva- Nuçi, Seb Bytyçi, Alison Felce, Cassie L. Barnhard dhe Werner.J.Stueber.

4. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Ardian Gola

Kryetar i Komisionit